

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vizita e Ramës në OKB, protestuesi: Nuk zhvilloi asnjë takim të nivelit të lartë. I kanë mbetur dy rrugë
ADRESA	https://piranjat.al/politike/vizita-e-rames-ne-okb-protestuesi-nuk-zhvilloi-asnje-takim-te-nivelit-t-i106348
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 19:48:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 19:47:24 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0c46435565cafa287d3dde6e7c6f0b79c5238331cb517ce20f2bce7042ce0922
TEKSTI	fb026ad908ad40acc70d595fe3a2369af76b3bdfd5f0b9e1c78e474e8ae70ed6
PAMJA	072f1aad28e88d7772e198965c76a0fda709a875e98b584f4611e6bf8debc935

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b5ea7f4d11b9cd93210d9de1fab22a0923e904a4c3223d711e9f81479c55ca2f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3aac5177b059e894026952c5b076c374c5dd6b2fda5f20c0a9390b2c535810d8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b5ea7f4d11b9cd93210d9de1fab22a0923e904a4c3223d711e9f81479c55ca2f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash: **metral Bashkia** "Piranja News", gjenden e **spektakolare** treguesit t'ijve që emigru... **dhe kryehajduti** monologu të Edi Rama në Rinas, pasi e kishte **jetën nga zjarri në shtëpi** ku jetonte në **minimale** "shembull" nga familjet **më nd**

POLITIKE

Vizita e Ramës në OKB, protestuesi: Nuk zhvilloi asnjë takim të nivelit të lartë. I kanë mbetur dy rrugë

Piranjat Përditësimi i fundit 27 Shtator 2026, 21:47



Protesta qytetare vijoi për të 120-ën ditë radhazi, ndërsa një prej qytetarëve që mori fjalën para protestuesve u ndal te vizita e kryeministrit Edi Rama në New York dhe pjesëmarrja e tij në punimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Në fjalën e tij, protestuesi komentoi takimet dhe aktivitetet e Ramës gjatë qëndrimit në OKB, duke pretenduar se kryeministri shqiptar nuk zhvilloi asnjë takim të nivelit të lartë.

"Edi Rama ishte i vetmi udhëheqës, i vetëm, në mbledhjen e fundit të Kombeve të Bashkuara, i cili nuk zhvilloi asnjë takim të nivelit të lartë", deklaroi ai.

Protestuesi kritikoi gjithashtu fjalimin e kryeministrit në OKB, duke pretenduar se Rama e kishte kthyer vëmendjen te situata e brendshme në Shqipëri dhe se kishte folur në mënyrë negative për qytetarët shqiptarë dhe protestat që po zhvillohen prej muajsh.

Sipas tij, Rama nuk e shfrytëzoi vizitën në New York për takime diplomatike, ndërsa e cilësoi qëndrimin e kryeministrit në OKB si një "vetmi" në raport me liderët e tjerë.

"Madje nuk takoi as shokët e tij diktatorë me të cilët shoqërohet zakonisht", tha protestuesi, duke vijuar me kritikën ndaj kryeministrit.

Ai u ndal edhe te konferenca e Ramës në Rinas pas kthimit nga Shtetet e Bashkuara, duke pretenduar se kryeministri shmangu një përballje të drejtpërdrejtë me kërkesat e protestuesve për dorëheqje.

Sipas protestuesit, Rama duhet të japë dorëheqjen, ndërsa deklaroi se "i kanë mbetur vetëm dy rrugë: të japë dorëheqjen, ose të bëhet mbret".

"Mirë do ishte të jepte dorëheqjen, por paradoksisht dhe ironikisht, nuk do ishte keq edhe sikur të bëhej mbret", u shpreh ai, duke e përdorur këtë krahasim për të kritikuar mënyrën se si, sipas tij, Rama e ushtron pushtetin.

Në vijim të fjalës së tij, protestuesi bëri edhe akuzat të tjera ndaj qeverisë, duke pretenduar se pushteti përdor institucionet dhe mekanizmat shtetërorë për të ruajtur kontrollin politik. Ai përmendi edhe çështjen e ish-presidentit të Partisë Demokratike, Sali Berisha, masën e arrestit shtëpiak ndaj të cilit e cilësoi si "imunitet", si dhe situatën e zëvendëskryeministres Belinda Balluku.

"Prandaj, Rama jep dorëheqjen! Rama jep dorëheqjen!", ishte thirrja me të cilën protestuesi e mbylli fjalën e tij para qytetarëve të mbledhur pranë Kryeministrit.

Protesta e 120-të u shoqërua gjatë ditës me fjalime, pankarta, flamuj dhe marshim në rrugët e Tiranës, ndërsa pjesëmarrësit përsëritën kërkesat e tyre kundër qeverisë dhe për ndryshime politike e institucionale.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 27 Shtator20:27

["Vlorën dhe Agasin t'i sollën me zor në zyrë?"/ Aktivisti thirrje Ramës: Ik edhe për Zahon!](#)

Aktivisti Erald Ndoj ka reaguar ndaj video- mesazhit të publikuar sot nga kryeministri Edi Rama, lidhur me zhvillimet rreth skandalit të SHISH-it dhe ...

POLITIKE 27 Shtator20:10

["Mos kujtoni se ju kam vjedhur"/ Këlliçi-Ramës: Je kreu i narkoshtetit dhe kryehajduti i shqiptarëve, jep menjëherë dorëheqjen](#)

Nënkryetari i Partisë Demokratike, Belind Këlliçi, ka reaguar pas monologut të Edi Rama në Rinas, pasi e kishte njoftuar pë...

POLITIKE 27 Shtator19:46

[Rokada/ Ministri Hoxha ndërron ambasadorët në Prishtinë dhe në Shkup](#)

Ferit Hoxha, ministër i Punëve të Jashtme, çon përpara idenë e disa muajve më parë për ndryshimin e dy ambasador&...

POLITIKE 27 Shtator19:28

[‘Asnjë hap pas’/ Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!](#)

Sot shënohen 120 ditë protesta qytetare kundër qeverisë së Edi Ramës. Edhe këtë të diel, qytetarët u mbledh...

POLITIKE 27 Shtator19:27

[“Shkoi dhe erdhi si karafil”/ Arben Kola për vizitën e Ramës në SHBA: Bota i ka ‘hequr fishën’, Amerika e braktisi!](#)

Aktivisti Arben Kola ka komentuar vizitën e kryeministrit Edi Rama në SHBA, duke pretenduar se gjatë qëndrimit atje ai nuk është t...

POLITIKE 27 Shtator17:43

[Pse nuk bind alibia e kryeministrit "leshko", që nuk e dinte për Vlora Hysenin dhe Ergys Agasin](#)

Në daljen e tij pas kthimit nga Nju Jorku, Edi Rama përsëriti të njëjtën linjë mbrojtjeje që ka përdorur sa her&eum...

POLITIKE 27 Shtator17:03

[Monologu i Ramës/ Abilekaj: Shmangu gazetarët për të mashtruar pa filtra](#)

Gazetari Enton Abilekaj, i ftuar në ‘Edicionin e Pasdites’ në SYRI TV me moderatorin Edvin Parruca, ka komentuar monologun e kryeministrit...

POLITIKE 27 Shtator16:57

[Shkullaku ironizon Ramën: Pas 28 vitesh në pushtet, paska dalë më i varfër se sa ka hyrë](#)

Gazetari Armand Shkullaku ka reaguar me ironi ndaj Edi Ramës, pas monologut të mbajtur në Rinas. Në reagimin e publikuar në rrjetet so...

POLITIKE 27 Shtator16:38

[Skandali me SHISH/ Rama sulmoi drejtësinë, Tabaku: Shqipëria nuk vuan nga një “republikë prokurorësh”](#)

Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, ka reaguar pas deklaratave të kryeministrit Edi Rama, i cili kritikoi drejtësinë dhe institu...

POLITIKE 27 Shtator16:09

[Blushi: Rama firmosi në shkëlje të ligjit për inceneratorët, ja dy rastet që e implikojnë](#)

Në një postim në rrjetet sociale, sekretari i Përgjithshëm i Partisë së Lirisë, Tedi Blushi, ka akuzuar kryeministrin Ed...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 27 Shtator

[Familja e kërkon prej vitesh/ Emisioni italian ...](#)

Rajmonda Kotorri, e cila u largua në Itali kur ishte vetëm 16 vjeçe dhe humbi kontaktet për vite me radhë me familjen e saj, dyshohe...

AKTUALITET 27 Shtator

[“Je rrezik për sigurinë kombëtare”, Azgan Hakla...](#)

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Azgan Haklaj, është ndaluar nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut në pikën kufitare t&...

AKTUALITET 27 Shtator

[Atentati në Athinë/ Ja çfarë i tha Denis Luli k...](#)

Sipas informacioneve të reja, katër autorët mbërritën në lokal me një automjet të vjedhur të enjten e kaluar n&eu...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqe nga 5...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2





PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!



Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.